



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 684/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 05 / 2018

V E N D I M

Nr. 122 , Datë 16 / 5 / 2018

Bazuar në informacionin¹ e marrë nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (ADRF) Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: *“Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”*, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara”*, me Urdhrin nr. 28, datë 13.02.2018 filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me problematikën e sjellë nga neni 35 i Ligjit nr. 104/2014, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”” dhe rregullimin e së drejtës për t’u vlerësuar në KMCAJ të të gjithë personave me aftësi të kufizuara të cilët janë invalid pune.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Sipas informacionit të dhënë, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka ngritur dy problematika në të cilat kanë shpjeguar se: Problematika e parë, ka të bëjë me Ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””. Ky ligj sipas konstatimeve të ADRF-së, ka ndryshuar kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit, përkatësisht nenin 35 të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” duke përcaktuar se: *“1. Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë: a) për çdo veprimtari ekonomike; b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor*

¹ Shkresë e protokolluar me tonën nr. 595, datë 07.06.2017

i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprorë caktohen me këtë Ligj. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me Rregullore të ISSH-se dhe Ministrisë së Shëndetësisë. 2.Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror”.

ADRF ngre shqetësimin se, kjo përbën diskriminim të tërthortë dhe është në shkelje të parashikimeve të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke e argumentuar si më poshtë: *“Kushtëzimi i të drejtës së përfitimit të pensionit të invaliditetit të personit me aftësi të kufizuara, që gjatë 5 viteve të fundit nuk ka qenë i siguruar për së paku 12 muaj, ka sjellë diskriminimin e kësaj kategorie në raport me kategoritë e tjera përfituese dhe kjo për shkak se janë të përjashtuar nga të dyja skemat e ndihmës së personave me aftësi të kufizuara”.*

ADRF shpjegon se: *“Deri në vitin 2014, ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i njihte të drejtën e përfitimit të pensionit të invaliditetit individit i cili ishte bërë i paaftë për punë por që gjatë jetës së tij kishte kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror, në cilindo moment të jetës dhe i pakushtëzuar nga vitet dhe periudha e derdhjes së kontributeve. Ndërsa, individi i cili është bërë i paaftë dhe në asnjë moment të jetës nuk ka kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror, përfiton ndihmë ekonomike bazuar në ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Ndryshimet që solli ligji nr. 104/2014, datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", duke kushtëzuar të drejtën e përfitim me periudhën minimale të sigurimit prej 12 muajsh gjatë 5 viteve të fundit, i ka vendosur invalidët e punës në kushte diskriminuese brenda vetë skemës së pensionit të invaliditetit”.*

ADRF thekson se: *“Ndryshimi i kushteve të përfitimit të pensionit të invaliditetit ka lënë këtë kategori personash me aftësi të kufizuara pa asnjë mbrojtje. Invalidi i punës që ka kontribuar në vazhdimësi në skemën e sigurimeve shoqërore, por që nuk ka qenë në marrëdhënie pune gjatë 5 viteve të fundit dhe bëhet i paaftë për të punuar, ligji nr. 104/2014, date 31.07.2014 nuk ia njeh kontributet që ai ka derdhur në skemën e sigurimeve shoqërore ndër vite. Mungesa e mbrojtjes së kësaj shtrese të invalidëve të punës i vendos ata në kushte shumë të vështira pasi nuk kanë asnjë mbështetje për kujdes shëndetësor dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës”.*

Problematika e dytë, që ngre organizata ADRF, është në lidhje me Ligjin 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në të cilin ka konstatuar se terminologjia e përdorur është diskriminuese, e vjetruar dhe jo në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. Termi "i paaftë" apo "invalid", i cili nënkupton një person "të pavlefshëm", është paragjyqës dhe fyes për personat me aftësi të kufizuara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr.253/1, datë 20.02.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, duke i vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe duke i kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Me shkresën Nr.253/2, datë 20.02.2018 i është kërkuar subjektit, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara që të vendosë në dispozicion të Komisionerit të gjithë dokumentacionin që dispononte me shpjegime konkrete nga ana e individëve që mund të kenë ngritur këtë problematikë pranë organizatës, në të cilën të faktohet me dokumente (nëse ka) përkeqësimi i situatës për personat me aftësi të kufizuara pas ndryshimeve ligjore të sipërcituara. Gjithashtu, i është kërkuar të jepnin sugjerime mbi ndryshimet në terminologji, bazuar mbi eksperiencën e organizatës.
- Me shkresat nr. 481 dhe 481/1, datë 05.04.2018 të dërguar nga Komisioneri, janë kujtuar dhe njëherë subjektet për të dërguar informacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 1510/2, datë 13.04.2018, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, vendosi në dispozicion të Komisionerit, informacionin për numrin e personave të cilët kanë përfutur pension invaliditeti gjatë periudhës 2011-2017 (tabela më poshtë) si dhe kriteret për përfshirjen në skemën e invaliditetit në disa vende Evropiane si: Belgjikë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Luksemburg, Maltë, Monako, Norvegji, Spanjë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Austri. Në lidhje me përdorimin e termit “i paaftë dhe invalid”, ISSH shpjegoi se: “Sipas Fjalorit

të Gjuhës Shqipe fjala i “paaftë” nënkupton një person “që nuk është i aftë të bëjë diçka, që nuk i ka mundësitë e forcat e një njeriu të zakonshëm për të kryer një punë”. Në këtë kuptim me termin “i paaftë” në ligjin nr.7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, kuptojmë një person i cili nuk mund të kryej një punë për shkak të gjendjes shëndetësore. Më konkretisht termi “i paaftë” shpreh paaftësinë fizike të individit lidhur me punën që ai ka bërë deri në momentin që kërkon vlerësim të gjendjes së tij shëndetësore. Ndërsa termi “invalid” është term që përdoret gjerë për kategorizimin e personave të cilët nuk mund të punojnë fare për shkak të gjendjes shëndetësore, ose kanë humbur plotësisht ose pjesërisht aftësinë për të kryer punën që bënin deri në momentin kur u shfaqën problemet shëndetësore. Ky term përdoret dhe në ligje të tjera si: “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, “Për statusin e invalidëve të punës” dhe “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”.

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
NUMRI I PENSIONEVE TË INVALIDITETIT NË VITE

	Numri i pensioneve të invaliditetit në fund të vitit						
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Pensione invaliditeti gjithsej (urban)	52.019	55.241	59.237	61.196	62.098	61.935	62.409
1. Nga sëmundje të përgjithshme	49.232	52.466	56.492	58.606	59.541	59.405	59.901
-të perhershëm	3.398	3.466	3.682	5.382	5.449	5.480	5.426
-të plotë me kujdesje	903	895	919	1.077	1.070	1.047	999
-të plotë	31.892	34.262	36.763	37.603	37.521	36.749	36.468
-të pjesshëm	8.477	8.322	8.160	6.311	5.921	5.628	5.318
-të reduktuar	4.562	5.521	6.968	8.233	9.580	10.501	11.690
2. Nga aksidentet në punë dhe sem.prof	2.787	2.775	2.745	2.590	2.557	2.530	2.508
-të perhershëm	519	527	528	638	638	646	648
-të pjesshme 33%-66%	1.433	1.415	1.391	1.373	1.351	1.322	1.306
-të plotë 67%	734	730	723	532	521	517	509
-të plotë me kujdesje	101	103	103	47	47	45	45
Pensione inaliditeti gjithsej (rural)	6.662	6.853	7.229	7.579	7.763	7.456	7.304
1. Nga sëmundje të përgjithshme	6.375	6.568	6.949	7.330	7.518	7.215	7.069
-të perhershëm	631	636	646	834	849	870	867
-të plotë me kujdesje	191	188	191	195	196	197	194
-të plotë	3.817	3.785	3.696	3.543	3.377	3.180	3.036
-të reduktuar	1.736	1.959	2.416	2.758	3.096	2.968	2.972
2. Nga aksidente	287	285	280	249	245	241	235
-të perhershëm	37	38	38	38	37	36	33
-grupi i I	10	10	11	11	12	12	12
-grupi i II	86	85	85	27	28	29	29
-grupi i III	154	152	146	173	168	164	161

Me shkresën nr. 115, datë 17.04.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, informoi se: “FSHDPAK nuk disponon dokumentacion nga individë të cilët janë prekur nga problematika e ngritur për arsye se personat e prekur e kanë të pamundur të faktojnë me dokumentacion përkeqësimin e situatës për shkak se nuk mund të aplikojnë më për të vlerësuar gjendjen shëndetësore nga KMCAJ”.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/3, parashikon se: “*Diskriminimi i tërthortë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

Përsa më sipër, Komisioneri analizoi situatën e sjellë në vëmendje nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parë kjo në respektim të zbatimit të legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar.

Kështu, Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”. Neni 18, i saj shpreh se “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqet e parashikuar në të*”.

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore. Në këtë Konventë, përcaktohet se: “*...personat me aftësi të kufizuar janë të gjithë personat që vuajnë nga një aftësi e kufizuar afatgjatë fizike, mendore, intelektuale, apo ndjesore e cila duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme negative apo pengesat fizike, mund t’i pengojë këto persona për t’u përfshirë plotësisht në shoqëri*”.

Në analizë të legjislacionit të ndryshuar, Komisioneri konstaton se:

- Deri në datë 31.07.2014, ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar në nenin 35/2 ka parashikuar se: “*Periodha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa gjysma e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç*”.

- Ndërsa me miratimin e ligjit nr. 104/2014, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i cili do shtrinte efektet nga data 01.01.2015, neni 35/2, ka ndryshuar duke përcaktuar se: *“Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror”*.

Në lidhje me ndryshimet ligjore në Ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në Raportin e Parë Kombëtar për zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” të miratuar me VKM nr. 460, datë 27.05.2015 “Për miratimin e raportit të parë kombëtar për zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në paragrafin 195 është shprehur se: *“Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për sigurimet shoqërore në RSH", parashikoi ndryshime në formulën e përlogaritjes së viteve të punës që i duhet një personi të siguruar për të përfutur pension invaliditeti. Konkretisht, periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe, në 5 vitet e fundit para lindjes të së drejtës, të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Ndryshimet e fundit ligjore kanë pasur si qëllim incentivimin e qytetarëve që të rrisnin në mënyrë reale periudhat kontributive dhe masën e kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore. Formula e llogaritjes së përfitimeve është e njëjtë me atë të pensionit të pleqërisë, duke vendosur si dysheme për invalidët, 75% të pagës minimale në shkallë vendi të vitit të fundit të punës para momentit të fillimit të invaliditetit, me synim ruajtjen e nivelit të të ardhurave që kishin para fillimit të aftësisë së kufizuar. Formula e aplikuar është shoqëruar me parashikimin se të gjithë invalidët nën moshën 50 vjeç, me kontribute deri në 15 vite, si rregull, përfitojnë pension të plotë invaliditeti, ndërsa ata që kanë më pak vite kontributive niveli i kërkesës për pension të plotë, marrin një pension të reduktuar në raport me vitet e punës”*.

Referuar tabelës së të dhënave² të siguruara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në lidhje me problematikën që po shqyrtohet, vlerësohet se nuk kemi ndryshim të dukshëm në numrin e personave që përfitonin pension invaliditeti nga viti 2014 në vitin 2015 e në vijim, vit kur është zbatuar ndryshimi ligjor i cili kërkonte që personi që kërkonte pension invaliditeti të kishte gjatë pesë viteve të fundit 12 muaj punë të siguruar.

Bazuar në të dhënat e sipërcituara dhe në respektim të problematikës së ngritur nga FSHDPAK, vlerësohet se gjatë tri viteve të zbatimit të kësaj skeme nuk është arritur që të sigurohen të dhëna statistikore në mënyrë që të identifikohet trajtimi ndryshe i personave me aftësi të kufizuara të lidhur me një nga shkaqet e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

² Referuar tabelës së ISSH në fund të vitit 2014 ka patur 61.196 persona të trajtuar, në fund të vitit 2015 ka patur 62.935 persona, në fund të vitit 2016 ka patur 61.935 persona dhe në fund të vitit 2017 ka patur 62.409 persona të trajtuar me pensione invaliditeti.

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj çështjeje, në një vlerësim krahasues, Komisioneri në kuadër të bashkëpunimit me rrjetin EQUINET ka analizuar dhe legjislacionin e disa shteteve Evropiane në lidhje me kriteret për përfshirjen në skemën e pensionit të personave me aftësi të kufizuara.

Kështu, në legjislacionin e Finlandës parashikohet që: “Personat përfitojnë pension të aftësisë së kufizuar nëse: - të ardhurat e tyre në 10 vitet e fundit përpara aftësisë së kufizuar të ishin 17,480.28 euro dhe – të jenë paguar sigurimet shoqërore mbi të ardhurat”.

Në legjislacionin e Letonisë parashikohet që: “Shuma e pensionit për personat me aftësi të kufizuara të Grupit I dhe II varet nga: - Paga mesatare mujore e cila i nënshtrohet kontributeve të sigurimit të personit të siguruar për 36 muajt e njëpasnjëshëm në pesë vitet e mëparshme para dhënies së pensionit të aftësisë së kufizuar”.

Gjithashtu nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore u vendos në dispozicion të Komisionerit dhe një material informues mbi legjislacionin në disa shtete Evropiane për kriteret e përfshirjes në skemën e pensionit të aftësisë së kufizuar.

Në analizë të legjislacionit të këtyre shteteve vlerësohet se dhe në shtetet si: Belgjikë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Luksemburg, Maltë, Norvegji dhe Spanjë, përfitimi i pensionit për aftësinë e kufizuar është i lidhur me kohëzgjatjen e periudhës së sigurimit dhe pagesën e sigurimeve shoqërore për një periudhë përpara së të fillonte aftësia e kufizuar.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/3, parashikon se: “*Diskriminimi i tërthortë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, vendosja e kushtit për periudhën kontributive është një eksperiencë ndërkombëtare që i shërben rritjes së skemës së sigurimeve shoqërore dhe nuk është diskriminuese pasi nëse personi bëhet me aftësi të kufizuar kur nuk ka qenë në punë mund ti drejtohet skemës së ndihmës ekonomike për aftësinë e kufizuar, e cila jepet pavarësisht nga kontributet.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga FSHDPAK, se përdorimi i termit "i paaftë" apo "invalid"³, në Ligjin 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar është diskriminues, i vjetruar dhe jo në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, Komisioneri vlerëson se terminologjia e përdorur në ligjin e sipërpërmendur por dhe në ligje të tjera të legjislacionit Shqiptar duhet të rishikohet dhe të

³ Termi “i paaftë” mund të zëvendësohet me termin – pamundësi fizike, mendore, etj, ndërsa termi “invalid” mund të zëvendësohet me termin – person me aftësi të kufizuara.

përshtatet për t'u pajtuar më mirë me konceptet moderne, të reja të përshkruara në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/3, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara që nuk përfitojnë pension të plotë apo të pjesshëm, për shkak të moskontribuimit me 12 muaj sigurim shoqëror në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës për pension të aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkaku: aftësia e kufizuar)
(fusha: te mira dhe sherbime)